



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	14.01. 2020
<b>REFERENC-Ë:</b>	18/1792/2-217/DMMU
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"PROenergy" Sh.p.k. Brestoc, Rahovec
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 18/1792/2-217/DMMU, dhe ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of  
the General Secretary*

---

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 21 paragrafi 4 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

**V E N D I M**

Deklarohet i përfunduar procedimi administrativ i kërkesës së kompanisë "PROenergy" Sh.p.k. Brestoc, Rahovec, për Pëlqim Mjedisor, për prodhimin e 1.2 MW Hidroenergji elektrike në lumin Korishë, Komuna e Prizrenit.

**A r s y e t i m**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të kompanisë "PROenergy" Sh.p.k. Brestoc, Rahovec, për Pëlqim Mjedisor, për prodhimin e 1.2 MW Hidroenergji elektrike në lumin Korishë, Komuna e Prizrenit, vlerëson si në vijim.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar se mungon dokumentacioni në vijim:

- Pëlqimi i Komunës për prodhimin e 1.2 MW Hidroenergji elektrike në lumin Korishë, Komuna e Prizrenit në ngastrat kadastrale nr.2475-0, nr. 3428-0, nr. 0666-0, nr. 0655-0, jo më të vjetra se gjashtë muaj
- Kontratën për shfrytëzimin e ngastrave kur ngastrat nuk janë pronë e aplikuesit

Faqe 2 nga 3

---

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë  
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/nmph>, E-mail: [zsp.nmph@ks-gov.net](mailto:zsp.nmph@ks-gov.net)



Dokumentacioni i kërkuar nuk është sjellur në bazë të kërkesës për plotësim dokumentacioni të datës 04.11.2019.

Për tu shqyrtuar kërkesa e Juaj, keni qenë të obliguar që të sjellni dokumentacionin e lartcekur.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ju ka dërgua kërkesën më datë 04.11.2019 për **Plotësimin e dokumentacionit**, ku në bazë të nenit 21, paragrafët 2. dhe 3. të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214, është përcaktuar afati ligjor, të cilin afat nuk e keni respektuar për sjelljen e dokumentacionit të lartcekur.

**Deklarohet i përfunduar procedimi administrativ** i kërkesës së kompanisë "PROenergy" Sh.p.k. Brestoc, Rahovec për Pëlqim Mjedisor me nr.prot.: 18/1792/2-217/DMMU , për prodhimin e 1.2 MW Hidroenergji elektrike në lumin Korishë, Komuna e Prizrenit.

Bazuar në mangësitë e dokumentacionit administrativ, si dhe në pamundësinë e marrjes së vendimit përfundimtar, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/1792/2- ZSP/19 /20 datë:14.01.2020

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm



Faqe 3 nga 3